



№ 352 Prot  
24.07.2018

Tiranë me 20 Korrik 2018

Prot Nr. 156-1

**Objekti** : (34378) Përgjigje-Kthim Përgjigje

Drejtuar : Z. Ilir Butka  
Qendra Kombëtare e Kinematografisë

Për dijeni : Zonjës Mirela Kumbaro Furxhi  
Ministër i Kulturës

Zonjës Lindita Nikolla  
Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Zoti kryetar,

Në përgjigje të shkresës tuaj dt. 9.7.18, ku që në rrjeshtin e parë n'a shkruani «... me shpresën për të patur një sqarim përfundimtar dhe shterues...», arsyetojmë se çështje që lidhen me koncepte e interpretime ligjore si domosdoshmëri reformash, nuk mund të jenë as përfundimtare e as shteruese, por dinamike, progresive dhe konstruktive.

Për fat të keq këto moskuptime nga ana juaj, po n'a rrëmbejnë jo pak energji, të cilat do të ishin më të dobishme, po të përdroreshin në shërbim të interesit kulturor.

Më konkretisht ju thoni se sipas pikës 6 të ligjit nr. 8096, dt.21.3.96 QKK, organizon dhe mbështet financiarisht projekte «...për kualifikimin, specializimin dhe përgatitjen e kineastëve të rinj...» dhe në pikën a. të letrës tuaj shkruani «kjo pikë bën fjalë për projekte që organizohen nga QKK».

Nuk bën sens që QKK të bëjë projekte që do të miratohen dhe mbështeten financiarisht nga vetë QKK. Kjo është një praktikë krejtësisht e gabuar, e pabazuar në ligj dhe përbën konflikt interesi.

QKK organizon politika prej të cilave burojnë inisiativa krijuese e projekte të shtëpive kinematografike e subjekteve të tjera që veprojnë në këtë fushë.

Në letrën tuaj keni një keqinterpretim të ligjit dhe konceptit autor dhe student.

Studentë nuk janë autorë. Ato matrikulohen si studentë nga njësitë akademike.

Kur ky status mbaron, ato fitojnë një titull diplome në fushën ku kanë studiuar. Madje, për t'u konsideruar autorë, e për të pasur përgjegjësinë dhe të drejtën e përdorimit të fondit publik, duhet patjetër të kenë stazhin e domosdoshëm me orë pune kualifikuese të cilat në vetvete garantojnë sigurinë financiare të shpenzimit të fondit publik.

Nuk po merremi më me togfjalëshin Memorandum apo Akt-Marrëveshje.

**AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI**

Kinostudio - Rr. Aleksandër Moisiu nr.78 - Tirana 1005 - Albania

Tel./Fax : +355 42 365 188/157

[info@afmm.edu.al](mailto:info@afmm.edu.al)

[www.afmm.edu.al](http://www.afmm.edu.al)



Lidhur me detyrimin ose jo ligjor të QKK për të nënshkruar Akt-marrëveshje, ju sjellim në vëmendje precedentët e marrëveshjeve që QKK dhe MK ka nënshkruar gjatë këtyre viteve me Komisione Rajonale Filmi Italiane, Cineuropa, Platforma Shfrytëzimi online Maqedonase etj.

Përsa i përket pjesëmarrjes së një përfaqësuesi të QKK në Këshillin e AFMM, të cilin ju e konsideroni konflikt interesi, kjo e fundit nuk qëndron. Do të ishte konflikt interesi nëse shtëpia kinematografike Orafilm do paraqiste një projekt në Këshillin e Miratimit të Projekteve, gjë të cilën ju po e kërkonit me këmbëngulje. Por, AFMM nuk bën fjalë për paraqitje projektesh por për Akt-Marrëveshje institucionale QKK-AFMM.

Më poshtë ju shkruani «AFMM nuk është shtëpia kinematografike». Kjo është e pa vërtetë, sepse AFMM në çdo dokument, në QKR, në gjykatë, në çdo vendim të Këshillit të Ministrave madje që në themelimin e saj në 2004 e deri më sot, është aktivitet ligjor dhe legjitim i shtëpisë kinematografike Orafilm. Programi i studimeve kinematografike në AFMM, nuk mund të miratohet nga KMP, pasi këtë të fundit e miraton MASR.

Po kështu, nuk është e vërtetë se AFMM u krijua më 2007 dhe shkolla e Filmit dhe Multimedias Marubi në 2003.

Shkolla e parë e Filmit dhe Multimedia Marubi u hap më 4 Tetor 2004.

Në 2007 në gjykatë u zëvendësua fjala Shkollë me Akademi në zbatim të Ligjit të Arsimit të lartë të ndryshuar në 2007, duke qënë po i njëjti institucion, në të njëjtin vend dhe me të njëjtin aktivitet që kryen dhe sot.

Mendojmë se është koncept i gabuar dhe i dëmshëm moskonsiderimi i AFMM-së nga QKK, si pjesë e politikës e strategjisë së zhvillimit afatgjatë të kinematografisë sonë.


Lidhur me zërat e buxhetit të QKK, pikërisht prandaj kërkojmë përmes akt-marrëveshjes së propozuar, që duke nisur nga viti ekonomik 2019 të parashikohet në buxhetin e QKK zëri i financimit për AFMM. Deri në fillim të 2019, financimi për AFMM mund të alokohet nga zërat aktualë.

Theksojmë dhe një herë, nuk po kërkojmë ndihmë apo favor, por vetëm zbatim të ligjeve dhe ndalimin e dëmit që vazhdon prej vitesh, kundrejt zhvillimit të Akademisë Filmit dhe Multimedias Marubi si dhe kinematografisë Shqiptare.

Falemnderit për mirëkuptim.

Me respekte

Kujtim Çashku  
Drejtor i AFMM



**AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI**

Kinostudio - Rr. Aleksandër Moisiu nr.78 - Tirana 1005 - Albania  
Tel./Fax : +355 42 365 188/157 [info@afmm.edu.al](mailto:info@afmm.edu.al) [www.afmm.edu.al](http://www.afmm.edu.al)